

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar
“ SI IMPORT - EXPORT TRADE ” sh.p.k
Forma e Shoqërisë

Neni 1

Sot, më datë 28/07/2023 ne themeluesi Saimir Islamaj, ka krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“SI IMPORT - EXPORT TRADE ” sh.p.k.** Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti i Themelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1.Z. SAIMIR ISLAMAJ , shtetas shqiptarë,i datëlindjes 22.08.1988 i lindur në Vlore , dhe banuese në Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavaresia, Rr Irakli Pylli, Ndertesa 1, Hyrja 2, 9403; Vlorë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me Nr.BR9080687 dhe ID I80822069L.

Qendra e Shoqërisë

Neni 2

Selia e Shoqërisë **“SI IMPORT - EXPORT TRADE ” sh.p.k.** ndodhet ne adresën: Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavaresia, Rr Irakli Pylli, Ndertesa 1, Hyrja 2, 9403 Shoqëria mund te hape filiale te tjera ne te gjithe territorin e Republikës se Shqipërisë. Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

Kohëzgjatja e veprimtarisë ekonomike

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Neni 4

• .Import eksport, tregti me shumice dhe pakice te dyerve te jashtme dhe te brendshme , pjese dhe aksesore perberes te dyerve.

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emertimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve.

Kapitali i shoqërisë

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 (Një qind mijw) Lekë .

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme që nënkuptohet i përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme prej 100.000 lekë. Kjo kuotë i përket ortakëve si më poshtë:

1. **SAIMIR ISLAMAJ** zotërues e 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100 000 lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakëve.

Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që permban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 8

Ortakët e shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tij nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetem pasi të nxirret bilanci i shoqërisë për fitimin e realizuar.

Neni 9

Emërtimi i shoqërisë tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratorëve si dhe emrat e ortakëve duhet të jenë të permendura në të gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqëri dhe që ju drejtohen të tretëve. Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme dhe me përmbajtjen përreth saj.

Neni 10

Shoqëria vepron nën regjimin e pronës private dhe merr përsipër vete të drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtë kontraktore. Ortakët e shoqërisë drejtojnë procesin për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë si dhe për detyrimet që ka shoqëria ndaj të tretëve pa asnjë kufizim.

Kompetencat e ortakëve

Neni 11

Për mënyrën e drejtimit dhe ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, ortaku shprehet me vendime për gjithçka që është në kompetencat e tyre të përshkruara si më poshtë:

Kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në statut.

Kanë të drejtë të miratojnë bilancin e shoqërisë dhe të bëjnë ndarjen e fitimit.

Ata emerojnë administratorët, zëvendësit, ekspertet dhe revizoret kontabël.

Ata aprovojnë çdo lloj veprimi financiar që me ligj dhe me marreveshje lihet në kompetencat e tyre

Miratojnë zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit

Përcaktojnë shpërblimin për administratorin, ekspertet, revizoret kontabël.

Bëjnë transferimin e kuotave të të tretët. Bëjnë lidhjen e kontratave për dhënie dhe marrje të drejtash ose ekskluzivitet për tregtimin dhe prodhimin e mallrave të shoqërisë si dhe kontrata në lidhje me organet shtetërore për pjesëmarrjen në tender ankande ose aktivitete të tjera të rëndësishme. Realizojnë blerje, shitje si dhe tjetërsim të pasurive të paluajtshme të shoqërisë. Kanë të drejtë të bëjnë modifikimin e kontratës së shoqërisë, etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakëve, mbajtja e procesverbaleve dhe të gjitha dokumentat e tjera që kanë të bëjnë me të duhet të bëhen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

Administrimi

Neni 13

Administratori i shoqërisë është caktuar znj. **REZARTA ISLAMAJ**, shtetas shqiptarë, i datëlindjes **13/01/1987** i lindur në **Vlore**, dhe banuese në Vlore Vlore VLORE Lagjja Pavaresia, Rr Irakli Pylli, Ndertesë 1, Hyrja 2, 9403; **Vlorë madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me Nr.BB6511827 dhe ID I75113091D**

Afati i mandatit është 5 (pesë) vjet.

Neni 14

Administratori mund të emerojë një ose më shumë administrator të deleguar ose perfaqësues të thjeshtë për të kryer veprime të vecanta duke përcaktuar fuqinë e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet në fuqi. Detyrat e tyre do të përcaktohen në një rregullore të brendshme të shoqërisë.

Neni 15

Administratori ka liri të plotë për drejtimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha llojet e veprimeve dhe çdo lloj marrëveshje për realizimin e qëllimeve të shoqërisë duke përjashtuar rastet që janë të parashikuara në ligj dhe Statut që i takojnë ortakëve. Raporti i administrimit, inventari dhe llogaritë vjetore hartohen nga Administratori.

Marrëdhëniet e punës

Neni 16

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punës dhe legjislacionit të punës në fuqi.

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit

Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet të bëhet publike përmbajtja e tyre për të tretët e të gjitha akteve dhe dokumentave që janë përcaktuar si të tilla nga administratori i shoqërisë.

Ekspertet ose revizoret kontabë

Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një eksperti ose revizori kontabël. Ky ekspert do të qendrojë në detyrë për atë që sa përcaktohet me ligj dhe mund të rizgjidhet. Ortakët caktojnë dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma të vecanta ligjore. Asambleja e Ortakeve. Shërbime konsulence në Bujqësi dhe në funksion të objektit dhe aktivitetit që parashikon legjislacioni në fuqi.

Viti financiar, bilanci vjetor, shpërndarja e fitimeve

Neni 19

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor të secilit vit. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe përfundon me 31 dhjetor të të njëjtit vit.

Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhen brenda 6 muajve që nga fundi i vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet

Neni 20

Veprimtaria ekonomike do të mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti. Administratori merr masa për hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi veçohen fondet si me sipër paguhen detyrimet fiskale, të ardhurat që mbeten i kalojnë ortakëve të shoqërisë.

Neni 21

Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortakët vendosin brenda 4 muajve mundësinë e prishjes së jashtëzakonshme të shoqërisë.

Shpërndarja dhe likuidimi i shoqërisë

Neni 22

Në rast se shoqëria shpërndahet për çdo lloj arsye asambleja e ortakëve përcakton mënyrën e likuidimit, emëron një ose më tepër likuidator dhe përgatit të gjitha dokumentat e nevojshme për çregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqërisë

Neni 23

Po kështu shoqëria në bazë të ligjit mban librat e mëposhtëm:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve të administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve të ekspertëve ose revizoreve kontabël

Librat e mësipërm duhet të jenë të ruajtura për 10 vjet e çdo faqe duhet të jetë e vulosur.

Dispozita te pergjitheshme

Neni 24

Për sa është shprehur në këtë statut i referohemi Ligjit 9922, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjit 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Statutit dhe rregullores së brendshme të shoqëris. Çdo ndryshim bëhet në të njëjtën mënyrë sic është nxjerrë ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik të kësaj shoqërie.

Ortakët e

Shoqërisë me Përgjegjesi të Kufizuar

“SI IMPORT - EXPORT TRADE sh.p.k.

SAIMIR ISLAMAJ

Vlore më 28/07/2023